

KONTRATE SHITJE KAPITALI

SHITESI: MALO MANE, I BIRI I AQIFIT, I DATELINDJES 03/12/1953, LINDUR DHE BANUES NE SARANDE, ME ZOTESI JURIDIKE.

PRANUESA: NURIE MANE, E BIJA E NOVRUZIT, E DATELINDJES 06/11/1958, LINDUR NE PANDELEJMON DHE BANUESE NE SARANDE, ME ZOTESI JURIDIKE.

BLENDAR MANE, I BIRI I MALOS, I DATELINDJES 12/12/1980, LINDUR DHE BANUES NE SARANDE, ME ZOTESI JURIDIKE.

MERSIDA MANE, E BIJA E MALOS, E DATELINDJES 03/02/1984, LINDUR DHE BANUESE NE SARANDE, ME ZOTESI JURIDIKE

Palet me vullnetin e tyre te lire dhe te pavesuar lidhen kete kontrate per shitblerjen e kapitaleve:-----

Me vendimin nr. 4974 date 17/06/1994 te Gjykates se shkalles se pare Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin "MANE"SH.P.K.-----

Me vendimin nr.1 date 12/10/2002 te ortakut te vetem te kesaj shoqerie Malo Mane eshte vendosur shitja e 30 kuotave ose 30.000 leke te ortakut te vetem Malo Mane tek Nurie Mane, Bedar Mane dhe Mersida Mane te cilet marrin perkatesishte nga 10 kuota secili ose 10.000 leke ne kapitalin fillestar te shoqerise prej 100 kuota ose 100.000 leke. Ne keto kushte shoqeria behet me kater ortak te cilet kane perkatesishte nga 70 kuota ose 70.000 leke Malo Mane, 10 kuota ose 10.000 leke Nurie Mane, 10 kuota ose 10.000 leke Bledar Mane dhe 10 kuota ose 10.000 leke Mersida Mane ne kapitalin fillestar te shoqerise prej 100 kuota ose 100.000 leke. Duke qene se palet nuk kane asnje lloj kundershtimi per kete shitje kapitalesh dhe meqenese likujdimet i kane bere paraprakishte jane dakorte me formulimin e kesaj kontrate.-----

Kontrata e shitjes se kapitaleve bazohet ne nenin ne nenin 47 te ligjit nr.7638 date 19/11/1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe ne statutin e shoqerise.-----

Persa me siper meqenese eshte ne perputhje me ligjin dhe vullnetin e lire te paleve nenshkruhet rregullishte prej tyre. -----

SHITESI

B L E R E S A

MALO MANE

NURIE MANE

BLENDAR MANE

MERSIDA MANE

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA DELVINE

V E R T E T I M

NR. 353 REL.  
NR. 367 KOL.

Vertetoj se sot me daten 12/10/2002 para meje noterit te delvines Shkelqim Haxhi u paraqiten personalisht Malo Mane, Nurie Mane, Bledar Mane dhe Mersida Mane te cilet deklaruan se sa me siper eshte shkruar me deshiren e tyre. Une noteri duke patur njohje personale vertetoj firmat e tyre sipas ligjit.

NOTERI  
SHKELQIM HAXHI

